**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**

| Nr | Data e Kërkesës[1] | Objekti I Kërkesës[2] | Data e Përgjigjes[3] | Përgjigje[4] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[5] | Tarifa[6] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 01.06.2024 | Kërkesë për informacion për certifikatë trungu familjar | 03.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar mundësohen online në e-albania. Për këto certifikata, mund te aplikoni ne linkun si më poshtë: https://ealbania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=377 Certifikatë familjare (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja). Për të siguruar certifikatën e trungut familjar do zgjidhni opsionin: Certifikatë familjare për regjistrime të mëparshme (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja), nëpërmjet së cilës mundësohet verifikimi i të dhënave familjare të një historiku të mëparshëm në shqip ose gjuhë të huaj sipas periudhave të caktuara. Më pas zgjidhni opsionin Para vitit 2010. Plotësoni të dhënat që kërkohen në formular ku përfshihet dhe viti për të cilin u duhet dokumenti. Tek komentet keni mundesine te shkruani cdo sqarim apo detaj lidhur me dokumentin qe u nevojitet. Certifikata familjare gjenerohet me vulë elektronike. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

[1] Data e regjistrimit të kërkesës
[2] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[3] Data e kthimit të përgjigjes
[4] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[5] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[6] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 03.06.2024 | Kërkesë për informacion për leje drejtimi | 03.06.2024 | Përshëndetje, Duke qenë se kërkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni në kanalin tonë të komunikimit live chat në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për t'ju sqaruar hap pas hapi për rastin tuaj. Në këtë mënyrë mund të kuptojmë më mirë rastin dhe t'ju ndihmojmë në kohë reale. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 3 | 03.06.2024 | Kërkesë për informacion për Certifikatë nga akti i martesës | 03.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shërbimi "Certifikatë nga akti i martesës" mundësohet online në portalin e-albania. Duhet të aplikoni shërbimin, Certifikatë nga akti i martesës. Aplikimi realizohet online nga llogaria Juaj në e-albania. Nuk merret duke u paraqitur fizikisht pranë bashkisë apo prefekturës. Do zgjidhni opsionin, **Para vitit 2010.** Do përzgjidhni njësinë administrative. Tek Bashkia do zgjidhni Tiranë. Tek zyra e gjëndjes civile do u shfaqen dy opsione. Do përzgjidhni Zyra e arkivës së gjëndjes civile pranë Bashkisë Tiranë. Certifikatë nga akti i martesës (shqip / në gjuhë të huaj): https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11178<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 4 | 03.06.2024 | Kërkesë e paplotë për informacion | 03.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të e-mail tuaj, ju bëjmë me dije se mesazhi juaj është i paplotë. Lutemi vendosni në dispozicion printscreens me përgjigjet që keni marrë me qëllim që të verifikojmë rastin. Ju falenderojmë! | E plotë | Nuk ka |
| 5 | 03.06.2024 | Kërkesë për informacion për njehsim e diplomës nga IAL-të | 04.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju lutemi na telefononi në numrin 0800 0118 me qëllim që t'ju sqarojmë lidhur me shërbimin e njehsimit të diplomës dhe kartelën Informative ADISA për këtë shërbim. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 03.06.2024 | Kërkesë për informacion për vaksinimin e fëmijës | 04.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju duhet të drejtoheni pranë konsultores ku keni kryer vaksinat e fëmijës që të merrni vërtetimin që ju nevojitet. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 7 | 04.06.2024 | Kërkesë për informacion për pasaportë biometrike për fëmijën | 04.06.2024 | Përshëndetje, Lutem na kontaktoni në numrin 0800 0118 që t'ju sqarojmë për rastin tuaj. Kështu do të komunikojmë më qartë dhe ju vijmë më shpejt në ndihmë, Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 8 | 04.06.2024 | Kërkesë për informacion për leje ndërtimi | 05.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se taksa për ndërtimin e një objekti varet nga lloji i objektit, vlera e ndërtimit dhe zona ku do ndërtohet. Për të përfituar këtë shërbim, Ju duhet të logoheni dhe të aplikoni online në portalin e-albania për shërbimin: Aplikimi për Leje Ndërtimi (e-Lejet) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6093<br>Në këtë shërbim do aplikoni për "Leje ndërtimi për prishjen e ndërtimit ekzistues" dhe ngarkoni dokumentat si më poshtë: Dokumentacioni i nevojshëm që dorëzohet nga aplikanti:<br>1. Raporti teknik i ekspertëve për gjendjen fizike dhe ndërtimore të objektit që do të prishet<br>2. Vlerësimi i ndikimit në mjedis<br>3. Certifikata e pronësisë<br>4. Prokurë në rast se aplikanti nuk është vetë pronari, ose nëse janë disa pronarë. Ju bëjmë me dije se vetëm pasi të keni marrë lejen për prishjen e ndërtimit ekzistues dhe të keni kryer procedurat që vijojnë në përputhje me përgjigjen që do ju kthej institucioni, atëherë do të aplikoni për shërbimin Leje Ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m².<br>Bashkëlidhur do të gjeni kartelat informuese ADISA për të marrë informacion të plotë për shërbimet. Për cdo pyetje ose paqartësi, mund të na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | 05.06.2024 | Kërkesë për informacion për tatimin në burim | 05.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se, të gjithë tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitet, duhet të dorëzojnë në Drejtorinë Rajonale Tatimore një kopje të kontratës së qirasë apo të kontratës së pronësisë së ambientit. Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitet në ambientet e marra me qira duhet të llogaritin, mbajnë dhe derdhin për llogari të organeve tatimore, tatimin në burim deri në datën 20 të muajit pasardhës të kryerjes së pagesës së qerasë. Deklarimi dhe pagesa mund të kryhen online, përmes faqes zyrtare, por më parë është e nevojshme që individi përfitues të paraqitet pranë zyrës se Shërbimit të Tatimpaguesve, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse, për t'u regjistruar për përgjegjësinë tatimore të Tatimit në Burim, si dhe për t'u pajisur me fjalëkalimin për hyrjen në llogarinë e tij, në sistemin e deklarimit elektronik. Individi, përfitues i të ardhurave, duhet të dorëzojë brenda dates 20 të çdo muaji deklaratën e Tatimit në Burim, që përmban informacionin e nevojshëm mujor për të llogaritur detyrimin tatimor. Deklarimi kryhet vetëm elektonikisht dhe për këtë duhet të ndiqni hapat e mëposhtëm:<br>1. Hapet faqja zyrtare e administratës tatimore: www.tatime.gov.al<br>2. Në menynë "e-Shërbime" zgjidhet rubrika "individët", në të cilën klikohet për të aksesuar llogarinë e deklarimit elektronik.<br>3. Hapet dritarja e aksesimit në llogari, ku si emër përdoruesi vendoset numri personal (sipas Kartës së Identitetit dhe jepet fjalëkalimi përkatës).<br>4. Për të aksesuar llogarinë, duhet të zgjidhet: "E lexova dhe bie dakord me termat dhe kushtet".<br>5. Me hyrjen në llogari, në menynë "Deklarata" zgjidhet "Tatimi në Burim".<br>6. Tek rubrika "Deklarata të padorëzuara" listohen deklaratat, që duhet të plotësohen. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 7. Zgjidhet periudha për të cilën do të kryhet deklarimi. Individi përfitues i të ardhurave, plotëson rubrikën 15 “Pagesat për qiratë” të deklaratës së tatimit të mbajtur në burim, duke hedhur shumën mujore të përfituar nga qiratë dhe tatimin e llogaritur në masën 15%. Duke klikuar butonin “Dorëzo”, deklarimi përfundon dhe dorëzohet në Administratën Tatimore. Pas dorëzimit, deklarata mund të printohet për efekt dokumenti, duke klikuar butonin “Printo”. Për kryerjen e pagesës, individi, përfitues i të ardhurave, në menynë “Deklarata të dorëzuara”, zgjedh periudhën përkatëse dhe shtyp butonin “Printo Urdhër Pagesë”. Ky urdhër i printuar shërben për të kryer pagesën në sportelet e bankave të nivelit të dytë. Kujdes! Kur kontrata e qerasë është midis qytetarit dhe një subjekti tatimpagues (biznes), deklarimin dhe derdhjen e tatimit në burim e bën subjekti qiramarrës, pra biznesi. Në rast se qiramarrësi është individ, deklarimi dhe pagesa e tatimit në burim është detyrim ligjor i qiradhënësit. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat adisa.gov.al, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 10 | 05.06.2024 | Kërkesë për informacion për rivlerësim të provimeve të matures shtetërore | 05.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, po u dërgojmë linkun e faqes zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore Matura Shtetërore 2024. https://qsha.gov.al/matura-shteterore-2024/ Në fund të faqes keni kontaktin email ku të parashtroni kërkesën Tuaj. Ose mund të dërgoni email në adresën seldi.beta@qsha.gov.al. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 11 | 05.06.2024 | Kërkesë për informacion për shërbim ASHK | 05.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për informacion është e paplotë. Ju nuk keni sqaruar nëse ZVRPP Durrës ju ka kthyer përgjigje. Lutemi na kontaktoni në faqen zyrtare www.adisa.gov.al në livechat dhe na sqaroni më tej për aplikimin që keni kryer në mënyrë që të mund t'ju vijmë në ndihmë për rastin tuaj. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | 05.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për pajisjen me certificatë trugu për periudha kohore të mëparshme | 06.06.2024 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar mundësohen online në e-albania. Për këto certifikata, mund te aplikoni ne linkun si më poshtë: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=377<br>Certifikatë familjare (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja).Për të siguruar certifikatën e trungut familjar do zgjidhni opsionin:<br>Certifikatë familjare për regjistrime të mëparshme (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja), nëpërmjet së cilës mundësohet verifikimi i të dhënave familjare të një historiku të mëparshëm në shqip ose gjuhë të huaj sipas periudhave të caktuara.<br>Më pas zgjidhni opsionin Para vitit 2010. Plotësoni të dhënat që kërkohen në formular ku përfshihet dhe viti për të cilin ju duhet dokumenti.<br>Tek komentet keni mundësinë të shkruani çdo sqarim apo detaj lidhur me dokumentin që ju nevojitet. Certifikata familjare gjenerohet me vulë elektronike.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 13 | 06.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për pajisjen me pasaportë në rast humbje | 07.06.2024 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse për shërbimin pasaportë do të aplikoni nëpërmjet shërbimeve konsullore jashtë vendit, mjafton dokumenti i denoncimit që keni kryer në organet policore në Spanjë.<br>Në këtë rast do aplikoni shërbimin, "Aplikim për pasaportë dhe kartë identiteti", në linkun e mëposhtëm:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9765<br>Gjatë aplikimit duhet të zgjidhni datën dhe orën e takimit kur mund të paraqiteni në Ambasadë/Konsullatën përkatëse. Pas përfundimit me sukses të aplikimit do të njoftoheni me e-mail në lidhje me detajet e pagesës dhe dokumentacionit që duhet të keni me vete ditën e | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | takimit. Më pas do të paraqiteni në përfaqësi për të dhënë shenjat e gishtërinjve. Dokumentacioni bazë është:<br>1. Dokument identifikimi (kopje e pasaportës ose kartë identiteti shqiptare ose leje për drejtim automjeti model elektronik, model i ri, ose dokument me fotografi i lëshuar nga vendi pritës);<br>2. Denoncimi për humbjen e dokumentit (kartë identiteti dhe pasaporta) në organet policore të vendit ku ka ndodhur humbja.<br>Nëse do aplikoni për pasaportë në Shqipëri, duhet të bëni deklarimin e humbjes së pasaportës nga llogaria juaj në e-albania duke aplikuar shërbimin, "Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme", në linkun e mëposhtëm.<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14922<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 14 | 08.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për njohje kreditesh | 10.06.2024 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për t`u informuar mbi kreditet, duhet të aplikoni online në portalin e-albania shërbimin " Aplikim për statusin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë", në linkun e mëposhtëm:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14037<br>Fillimisht, në rast se nuk jeni regjistruar më parë, duhet të regjistroheni në këtë program duke aplikuar shërbimin " Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë", në linkun e mëposhtëm:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039<br>Pasi regjistroheni pajiseni me një kod e fjalëkalim nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | | |
| 15 | 09.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për pajisjen me pasaportë fëmije | 10.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të kryer aplikimin për pajisje të fëmijës për herë të parë me pasaportë, duhet te aplikoni nga llogaria e prindit në e-albania shërbimin: Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851 Klikoni opsionin "Përdor" dhe plotësoni formularin "Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës". Zgjidhni opsionin "Për fëmijën" dhe vazhdoni me plotësimin e të dhënave që u kërkohen. Ju nevojitet ngarkimi i fotografisë së fëmijës në standardin 4x5cm në formatin jpg, jpeg ose png. Në rastin kur aplikimi është me procedurë të përshpejtuar (ose aplikim emergjent), nevojitet përveç ngarkimit të fotos, edhe ngarkimi i kopjes së kuponit të procedurës së përshpejtuar. Pas shqyrtimit të aplikimit do të njoftoheni me sms dhe e-mail për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia. Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, duhet të keni me vete kuponin dhe fëmijën. Nëse fëmija e ka një pasaportë me afat 5-vjeçar, për të bërë rinovimin e pasaportës nuk është i nevojshëm aplikimi në linkun e mësipërm, por blihet kuponi në sportelet e Postës Shqiptare dhe paraqiteni tek IdentiTek. Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, duhet të keni me vete kuponin, pasaportën e mëparshme dhe fëmijën. Lidhur me pyetjen Tuaj, bëjmë me dije se fëmija mjafton të jetë i shoqëruar nga njëri prej prindërve.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | 09.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për reset password | 10.06.2024 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalëkalimin, për të gjeneruar një pasword të ri duhet të vepronі si mëposhtë:<br>Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al :<br>Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme:<br>• foto të kartës ID<br>• emri i nënës<br>• emri i babait<br>• vendlindja e nënës<br>Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5( pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri.Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 17 | 09.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për pajisjen me certifikatë martese | 10.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shërbimi "Certifikatë nga akti i martesës" mundësohet online në portalin e-albania. Për të marr shërbimin e kërkuar duhet të aplikoni shërbimin "Certifikatë nga akti i martesës". Aplikimi realizohet online nga llogaria Juaj në e-albania. Nuk merret duke u paraqitur fizikisht pranë bashkisë apo prefekturës.Pasi të hyni tek shërbimi i kërkuar duhet të çekoni opsionin, Para vitit 2010<br>Do përzgjidhmi njësinë administrative.<br>Tek Bashkia do zgjidhni Tiranë<br>Tek zyra e gjëndjes civile do u shfaqen dy opsione. Do të përzgjidhni Zyra e arkivës së gjëndjes civile pranë Bashkisë Tiranë.<br>Certifikatë nga akti i martesës (shqip / në gjuhë të huaj)<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11178 | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kërkesa Juaj është pak e paqartë, ndaj, për më shumë informacion, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 18 | 08.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për lidhje martese | 10.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është shpallja e martesës.Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentacioni i nevojshëm për shtetasin shqiptar në Republikën e Shqipërisë është:<br>• Letërnjoftim elektronik dhe jo pasaportë;<br>• Prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes.<br>Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:<br>• certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;<br>• dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);<br>• dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;<br>• fotokopje e dokumentit të identifikimit;<br>• prokurë e posaçme, në rastin kur nuk është prezent në procedurën e shpalljes<br>Këto dokumente duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, keni të drejtë ligjore të lidhni martesën duke pasur me vete dhe dy dëshmitarë me karta identiteti brenda afatit të vlefshmërisë. Pas lidhjes së martesës, Certifikata nga akti i martesës, legalizohet në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të regjistrohet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | | |
| 19 | 08.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për regjistrim në e-albania pa kartë identiteti | 10.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se regjistrimi në portalin qeveritar e-Albania mund të kryhet si për shtetasit shqiptarë, ashtu dhe për shtetasit e huaj të pajisur me leje qëndrimi në Shqipëri. Shtetasit shqiptarë regjistrohen nëpërmjet Numrit Personal të Identifikimit, të cilin e gjejnë në kartën e tyre të identitetit. Pasi të jetë hapur portali www.e-albania.al duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:<br>• Klikoni "Regjistrohu/Register"<br>• Plotësoni të gjitha të dhënat e specifikuara në formularin e regjistrimit<br>• Kodi i përdoruesit (NID: Numri personal i identifikimit) / User Personal Identification Number (NID): Është numri personal i identifikimit.<br>• Data e skadimit të kartës së identitetit / Identification document expiry date: Vendosni datën e skadimit të kartës së identitetit në formatin datë.muaj.vit.<br>• Fjalëkalimi / Password: Sigurohuni që fjalëkalimi të jetë 8 deri në 12 karaktere i gjatë dhe nuk duhet të fillojë ose mbarojë me hapësira. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • E-mail: Në këtë adresë do të vijë linku i aktivizimit të llogarisë dhe të gjitha njoftimet që kanë te bëjnë me aplikimet tuaja.<br>• Numri i celularit / Mobile phone number: Sigurohuni që të vendoset në formatin e duhur. Për numrat shqiptarë formati është '06xxxxxxxx' ndersa për numrat jashtë Shqipërisë, formati i saktë është '0044/0039/0032xxxxxxxx', në varësi të shtetit ku jetoni.<br>• Të dhënat personale (Emri / Name, Mbiemri / Surname, Atësia / Father Name, Mëmësia / Mother Name, Datëlindja / Birthdate): Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen më të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile.<br>• Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë", ose "ç".<br>• Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civle do të keni vështirësi me regjistrimin kontaktoni në adresën: helpdesk@e-albania.al.<br>• Plotësoni kodin katër shifror të dërguar me SMS në numrin tuaj të telefonit dhe klikoni në linkun e aktivizimit në adresën tuaj e-mail për aktivizimin e llogarisë tuaj.<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 20 | 08.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për lidhje martese | 10.06.2024 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se, pamvarësisht se njëri nga partnerët ka pasaportë angleze, nëse vazhdon të jetë i regjistruar në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri, martesa konsiderohet si akt civil midis dy shtetasve shqiptarë.Procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë është si më poshtë vijon :Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nuk ka rëndësi se në cilën njësi administrative apo komunë fillon procedura. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm duhet të jenë të dy bashkë.<br>Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:<br>• fotokopje e dokumentit të identifikimit brenda afatit të vlefshmërisë (Kartat e identitetit me vete të dy partnerët)<br>Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë kalendarike nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, janë të lirë të vazhdojnë me procedurat e lidhjes së martesës.Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00. Faleminderit! | | |
| 21 | 08.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për pajisjen me certifikatë martese | 10.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shërbimi "Certifikatë nga akti i martesës" mundësohet online në portalin e-albania. Duhet të aplikoni shërbimin, Certifikatë nga akti i martesës. Aplikimi realizohet online nga llogaria Juaj në e-albania. Nuk merret duke u paraqitur fizikisht pranë bashkisë apo prefekturës.<br>• Do çekoni opsionin, Para vitit 2010<br>• Do përzgjidhmi njësinë administrative.<br>• Tek Bashkia do zgjidhni Tiranë<br>• Tek zyra e gjëndjes civile do u shfaqen dy opsione. Do përzgjidhni Zyra e arkivës së gjëndjes civile pranë Bashkisë Tiranë.<br>• Certifikatë nga akti i martesës (shqip / në gjuhë të huaj)<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11178<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, pasi | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nëpërmjet dialogut pyetje-përgjigje në kohë rale, mundemi t`Ju ndihmojmë më shumë. Faleminderit | | |
| 22 | 07.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi vonesën në paisje me certifikatë lindje | 10.06.2024 | Përshëndetje z..Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.<br>Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të Znj.Rudi, e cila kërkon të informohet mbi vonesën për paisjen me shërbimin e kërkuar. S’a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj.Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 23 | 10.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi vonesën në paisje me certifikatë pronësie | 10.06.2024 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të Z.Hasa, e cili kërkon të informohet mbi vonesën për paisjen me shërbimin e kërkuar.S’a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj.Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 24 | 11.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e regjistrimit të kontratë së porosisë | 11.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të përfituar Certifikatën e Pronësisë së një prone, hapi i parë është regjistrimi i aktit me të cilin është përfituar kjo pronë. Në kërkesën Tuaj ku ju citoni që dispononi kontratë porosie duhet të aplikoni shërbimin "Regjistrim i akteve noteriale që lidhen ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të truallit apo me subjekte të treta" në linkun e mëposhtëm:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9443 | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në hapin e dytë, tek opsioni të dhënat e pronës, do vendoni zonën kadastrale ku ndodhet prona për të cilën po kërkoni informacionin, ndërsa për dy të dhënat e tjera, volum dhe faqe, do te vendosni numrat 9 ose 99, ashtu siç edhe e udhëzon portali gjatë aplikimit. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, pasi nëpërmjet dialogut pyetje-përgjigje në kohë rale, mundemi t`Ju ndihmojmë më shumë. Faleminderit | | |
| 25 | 11.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e anullimit të aplikimit | 11.06.2024 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të Z…., i cili kërkon të informohet mbi procedurën e anullimit të njërës prej kërkesave të kryera për bashkim pronash dhe saktësisht aplikimin me Nr:……..-08062024. S'a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 26 | 12.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e pajisjes me leje drejtimi në rastin që ka humbur | 13.06.2024 | Përshëndetje, Referuar kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se në rastin e humbjes së dokumentave të ndryshme, ju duhet të denonconi humbjes e dokumentit, në rastin tuaj Lejen e Qarkullimit, në linkun bashkëlidhur: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14922<br>• Si fillim identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania;<br>• Zgjidhni shërbimin "Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme";<br>• Klikoni butonin" Përdor";<br>• Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular;<br>• Pas përgatitjes së vërtetimit të humbjes, ju do të njoftoheni me e-mail dhe te seksioni "Dokumentet e mia" në e-Albania. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Pas deklarimit të humbjes së dokumentit të lejes së qarkullimit, do prisni konfirmimin nga sistemi e-albania. Sapo t'ju vij konfirmimi në sistem do vijoni me procedurën e aplikimit për rinovimin e patentës pranë sporteleve të DPSHTRR-së. Dokumentet që duhen me vete kur të paraqiteni në sportelin e DPSHTRR-së janë:<br>• Dokument identifikimi;<br>• Certifikatë mjekësore me fotografi, e cila vërteton aftësinë shëndetësore për të drejtuar mjetin rrugor;<br>• Lejen e drejtimit aktual që zotëron.<br>• Rinovimi i lejes së drejtimit: 3,500 lekë.<br>• Për të gjitha rinovimet e lejeve të drejtimit të kategorisë B që janë me afat 3/5-vjeçar ose janë me kufizime për shkaqe shëndetësore: 2,000 lekë.<br>Leja e re e Drejtimit tërhiqet pranë sporteleve të shërbimit të Drejtorive Rajonale ku është bërë aplikimi. Në Tiranë, leja e drejtimit tërhiqet për 30 minuta në zyrat e shërbimit te ish-NSHRAK. Në Drejtoritë e tjera Rajonale, kjo procedurë mund të zgjasë 3-5 ditë pune. Ju mund të gjurmoni lejen tuaj të re të drejtimit për të parë nëse është dërguar te drejtoria rajonale:https://www.dpshtrr.al/gjurmim-lejedrejtimi!<br>Kujdes! Në rast se nuk jeni i rregjistruar si shtetas shqiptar, ju nuk mund të kryeni deklarimin e humbjes së patentës. Për të vijuar me logimin në e-albania duhet të keni mjet identifikimi shqiptar, Kartë Identiteti apo passaportë. Në mënyrë që t`ju jemi sa më shumë në ndihmë, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit | | |
| 27 | 12.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e anullimit të aplikimit | 13.06.2024 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të Znj.Xhili, e cila kërkon të informohet mbi procedurën e anullimit të njërës prej kërkesave të kryera për llogari të institucionit tuaj dhe saktësisht aplikimin me Nr: 34233037-1000008-08062024, pagesë e kryer më 07.05.2024.S'a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit! | | |
| 28 | 11.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e pajisjes me certificate trugu familjar | 13.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar mundësohen online në e-albania. Për këto certifikata, mund te aplikoni ne linkun si më poshtë:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=377<br>Certifikatë familjare (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja). Për të siguruar certifikatën e trungut familjar do zgjidhni opsionin: Certifikatë familjare për regjistrime të mëparshme (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja), nëpërmjet së cilës mundësohet verifikimi i të dhënave familjare të një historiku të mëparshëm në shqip ose gjuhë të huaj sipas periudhave të caktuara.<br>Më pas zgjidhni opsionin Para vitit 2010.<br>Plotësoni të dhënat që kërkohen në formular ku përfshihet dhe viti për të cilin ju duhet dokumenti.<br>Tek komentet keni mundësinë të shkruani çdo sqarim apo detaj lidhur me dokumentin që ju nevojitet.<br>Certifikata familjare gjenerohet me vulë elektronike.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 29 | 11.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit pas | 13.06.2024 | Përshëndetje z….Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar".Bashkëngjitur | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | lidhjes së martesës | | gjeni kërkesën e mëposhtme të Znj…., e cila kërkon të informohet mbi mbi vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit pas ndryshimit të mbiemrit pas lidhjes së martesës.S'a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit! | | |
| 30 | 11.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e aplikimit me pasaportë biometrike për fëmijët | 13.06.2024 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se:Nëse fëmija e ka një pasaportë me afat 5-vjeçar, për të bërë rinovimin e pasaportës nuk është i nevojshëm aplikimi i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës, por blihet kuponi në sportelet e Postës Shqiptare dhe paraqiteni tek IdentiTek.Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, duhet të keni me vete kuponin, pasaportën e mëparshme dhe fëmijën.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 31 | 11.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e aplikimit për ndarje pasurie | 13.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Fillimisht duhet të hartoni 10 (dhjetë) planet e rilevimit sipas kufijve që i vendosni ju vetë me marrëveshje. Duhet të paraqiteni pranë një zyre noteriale, duke pasur me vete planet e rilevimit, certifikatën, kartelën dhe hartën e pasurisë dhe do bëni deklaratën noteriale të ndarjes së tokës sipas pjesëve takuese. Më pas do aplikoni shërbimin "Aplikim për regjistrimin e bashkimit, ndarjes apo pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9478 Dokumentet origjinale që i keni bashkëlidhur gjatë aplikimit duhet të dërgohen me postë pranë ZVRPP-se përkatëse. Mbani në konsideratë që zarfi i përcjelljes së këtyre dokumenteve të shoqërohet me numrin e aplikimit tuaj.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 32 | 13.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi reset paswordi si dhe vërtetim pensioni | 13.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalëkalimin, për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si mëposhtë:<br>Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al :<br>Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme:<br>- foto të kartës ID<br>- emri i nënës<br>- emri i babait<br>- vendlindja e nënës<br>Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5 (pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Duhet të mbani parasysh që këtë duhet ta bëni pë të dy prindërit.Pasi të pajiseni me passwordin e ri duhet të aplikoni nga llogaritë në e-albania të secili prind shërbimin "Vërtetim vjetor përfitimi afatgjatë" në linkun e mëposhtëm:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14988<br>Në mënyrë që t`ju jemi sa më shumë në ndihmë, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 33 | 18.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e aplikimit me pasaportë biometrike | 18.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të kryer aplikimin për pajisje me Pasaportë Biometrike për herë të parë, nevojitet të plotësoni online në portalin e-Albania formularin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke klikuar linkun:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851 | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Klikoni opsionin "Përdor" dhe plotësoni formularin "Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës". Gjatë aplikimit nevojitet ngarkimi i fotografisë në standardin 4x5cm në formatin jpg, jpeg ose png. Në rast se aplikimi është me procedurë të përshpejtuar (ose aplikim emergjent), nevojitet ngarkimi i fotos dhe i kopjes së kuponit të procedurës së përshpejtuar. Pas shqyrtimit të aplikimit do të njoftoheni në llogarinë Tuaj në e-albania në seksionin Dokumentet e mia, për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia. Nëse e keni rinovim të pasaportës dhe nëse pasaporta e mëparshme ka mbaruar afatin e vlefshmërisë pas vitit 2021, nuk është i nevojshëm plotësimi i formularit për komisariatin e policisë. Blini kuponin në postë dhe paraqituni tek IdentiTek duke pasur me vete dhe pasaportën që i ka përfunduar afati i vlefshmërisë. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 34 | 17.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për reset password | 18.06.2024 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalëkalimin, për të gjeneruar një password të ri duhet të veproni si më poshtë:<br>Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al :Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme:<br><br>• foto të kartës ID<br>• emri i nënës<br>• emri i babait<br>• vendlindja e nënës<br><br>Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5( pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | një fjalëkalim të ri. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 35 | 17.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e aplikimit me procedur të përshpejtuar për pasaportë biometrike | 18.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të kryer aplikimin për pajisje me Pasaportë Biometrike për herë të parë ose kur pasaporta juaj aktuale është lëshuar para datës 31 Dhjetor 2011, nevojitet të plotësoni online në portalin e-Albania formularin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke klikuar linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851 Klikoni opsionin “Përdor” dhe plotësoni formularin “Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës”.Ju nevojitet ngarkimi i fotografisë në standardin 4x5cm në formatin jpg, jpeg ose png. Në rast se aplikimi është **me procedurë të përshpejtuar (ose aplikim emergjent), nevojitet ngarkimi i kopjes së kuponit të procedurës së përshpejtuar.** Pas shqyrtimit të aplikimit ju do të njoftoheni me sms dhe e-mail për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia. Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, ju duhet të keni me vete kuponin dhe pasaportën aktuale që do të duhet ta dorëzoni pranë Zyrës së Identitek. Në rast se pasaporta aktuale është lëshuar pas datës 1 Janar 2012 duhet vetëm të blini kuponin dhe te paraqiteni tek Identitek pa qene nevoja te lini takim. Afati më i shkurtër për tù pajisur me pasaportë është brenda 72 orëve që realizohet duke paguar kuponin emergjent prej 18 mijë lekësh. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 36 | 17.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e aplikimit për pajisjen me | 18.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë dokumentin për të cilin interesoheni, duhet të paraqiteni pranë sporteleve të Postës Shqiptare, dhe të plotësoni formularin e kërkesës me të dhënat Tuaja. Posta Shqiptare e dërgon kërkesën pranë DRA që ka në juridiksion shkollën ku ju keni | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dokument të shkollës së mesme | | përfunduar arsimin 8-vjeçar. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 37 | 17.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e aplikimit të AV0 | 18.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se për të plotësuar një AV ose e quajtur ndryshe "Akt Verifikimi" ju duhet të logoheni me të dhënat tuaja në e-Albania dhe më pas të kërkoni shërbimin që ju keni aplikuar së fundmi, shërbim për të cilin do të plotësoni dokumentacionin me AV. Pas kërkimit të shërbimit ju duhet të klikoni **"Përdor"** dhe më pas do të vazhdoni në fund të faqes ku do të gjeni tabelën si më poshtë ku do plotësoni të gjitha të dhënat e nevojshme dhe më pas klikoni " DERGO".<br><br>Lidhur me pyetjen si të shtoj shërbime kur aplikoj AV0, bëjmë me dije se kur aplikoni AV0, nuk mund të shtoni asnjë shërbim tjetër.<br>AV0, ka kuptimin e aplikimit pa kosto. Të gjitha shërbimet kanë kosto. Për rrjedhojë, në një aplikim pa kosto, nuk aplikohen dot shërbimet që kanë kosto. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 38 | 17.06.2024 | Kërkesë për informacion nëse kërkesa e padisë për divorc mund të kryhet online | 18.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kërkesa për zgjidhje martese nuk mundësohet online. Kërkesë padia dorëzohet pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të palëve.<br>Dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesë-padinë për zgjidhje martese janë:<br>• Certifikata e martesës;<br>• Kopje e kartave të identitetit të palës paditëse dhe palës së paditur;<br>• Certifikatat nga akti i lindjes së fëmijëve (nëse çifti ka fëmijë);<br>• Vërtetimin e të ardhurave për palën paditëse dhe palën e paditur;<br>• Certifikatë pronësie mbi banesën bashkëshortore;<br>• Të dhëna bankare për palët.<br>Për çdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në online chat ose në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e hëna në të premte, nga ora 08.00 deri në orën 19.00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 39 | 17.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e pajisjes me vërtetim vendbanimi | 18.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, bëjmë me dije se në e-albania nuk ka një shërbim me emërtesë, "Vërtetim vendbanimi" që të mund të aplikoni nga llogaria Juaj në portal. Adresën e vendbanimit e keni të pasqyruar tek certifikata personale e cila u mundësohet nga llogaria juaj. Nëse u duhet si dokument tip në formë vërtetimi, paraqituni pranë njësisë Tuaj administrative. Per cdo pyetje paqartesi na kontaktoni  në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat , nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 40 | 17.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e pajisjes me leje për rikonstruksion shtëpie | 18.06.2024 | Përshëndetje znj.Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Si rrjedhojë, lutem | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | gjeni mëposhtë kërkesën, ku qytetari kërkon të informohet për procedure që duhet të ndjekë për aplikimin për leje rikonstruksioni. Gjithashtu bashkëlidhur dhe emaili drejtuar në adresën tone zyrtare. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të z…Faleminderit | | |
| 41 | 18.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e pajisjes me leje për mjet lundues | 18.06.2024 | Përshëndetje z….Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Si rrjedhojë, lutem gjeni mëposhtë kërkesën, ku qytetari kërkon të informohet për procedure që duhet të ndjekë për përdorimin e mjetit lundrues privat gjatë sezonit veror në Shqipëri. Gjithashtu bashkëlidhur dhe emaili drejtuar në adresën tone zyrtare. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të qytetarit. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 42 | 18.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi vonesën e aplikimit të kryer për korigjim kësti të tatimit të thjeshtuar | 19.06.2024 | Përshëndetje znj….Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Si rrjedhojë, lutem gjeni mëposhtë kërkesën, ku znj…. kërkon të informohet për vonesën e aplikimit të kryer për korigjim kësti të tatimit të thjeshtuar.Gjithashtu bashkëlidhur dhe emaili drejtuar në adresën tone zyrtare. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të znj….Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 43 | 19.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e mbylljes së pensionit të pleqërisë kur | 19.06.2024 | Përshëndetje znj….Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | personi ka ndërruar jetë jashtë vendit | | Sa më sipër lutem, gjeni mëposhtë kërkesën e qytetares, e cila kërkon të informohet mbi procedurën e mbylljes së pensionit të pleqërisë kur personi ka ndërruar jetë jashtë vendit dhe nuk disponon faturë shpenzimesh varrimi. Lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit! | | |
| 44 | 18.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e mbylljes së pensionit të pleqërisë | 19.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të përfituar shpenzimet e varrimit, duhet të aplikoni në e-albania shërbimin "Mbyllje pensioni", nëse i ndjeri ka qenë pensionist. Për të bërë mbylljen e pensionit, duhet të aplikoni nga llogaria e një familjari në e-albania shërbimin ”Aplikim për mbyllje pensioni” në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6162<br>**Hapat e procedurës**<br>• Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania;<br>• Zgjidhni shërbimin "Aplikim për mbyllje pensioni";<br>• Klikoni butonin "Përdor".<br>**Dokumentacioni**<br>• Certifikatë nga akti i vdekjes;<br>• Fatura e funeralit.<br>Dokumentet origjinale që i keni bashkëlidhur gjatë aplikimit duhet të dërgohen me postë pranë DRSSH përkatëse. Ju lutem mbani në konsideratë që zarfi i përcjelljes së këtyre dokumenteve të shoqërohet me numrin e aplikimit tuaj. Lidhur me pyetjen Tuaj, bëjmë me dije se certifikatën e vdekjes e dorëzon pranë qendrës së punës vetëm pasardhësi që ka qënë në certifikatë familjare me të ndjerën. Edhe në këtë rast mbështetja financiare nga subjekti ku punon pasardhësi është kompetencë dhe mundësi e tij. Rimbursimin e shpenzimeve funerale e përfitoni duke aplikuar shërbimin e mësipërm.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 45 | 19.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi vonesën e shërbimit fshirje hipoteke | 19.06.2024 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të Z….., i cili kërkon të informohet mbi afatin e përfundimit aplikimit me nr. … datë 04.06.2024 lirim prone nga banka. Gjithashtu bashkëlidhur dhe email-i drejtuar në adresën tonë zyrtare. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të z…..Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 46 | 19.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e pajisjes me kopje përgjigjes të testit së maturës | 20.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni shërbimin "Aplikim për kopje të testit të maturës/fletëpërgjigjes së maturës", në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11164<br>• Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania;<br>• Zgjidhni shërbimin “Aplikim për kopje të testit të maturës/fletëpërgjigjes së maturës";<br>• Klikoni butonin "Përdor";<br>• Plotësoni të gjithë të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular (shkolla, DAR/ZA, provimin përkatës, adresa);<br>• Klikoni butonin "Dërgo";<br>• QSHA-ja njoftohet në sistemin AMS për kërkesën e ardhur dhe verifikon të dhënat e dërguara nga aplikanti;<br>• Pas trajtimit të kërkesës, QSHA-ja nxjerr kopjet e provimit të maturës dhe materialin PDF të skanuar të cilin ia nis aplikantit te "Hapësira ime", në seksionin "Dokumentet e mia".<br>Ju do të njoftoheni dhe me e-mail, në kohën që shërbimi ka përfunduar. Koha e marrjes së shërbimit është, 10 - 25 ditë. **Bëjmë me dije se për këtë vit nuk është aktivizuar ende shërbimi. Ndiqni njoftimet në faqen zyrtare të QSHA për t`u informuar** | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **lidhur me datat e aktivizimit të shërbimit.** Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 47 | 19.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi vlerën prej 1 euro e shënuar në kartelën e pasurisë | 20.06.2024 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të Z…., i cili kërkon të informohet mbi vlerën prej 1 euro e shënuar në kartelën e pasurisë ndërkohë që prona është rivlerësuar në 2020. Gjithashtu bashkëlidhur dhe email-i drejtuar në adresën tonë zyrtare. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të z….Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 48 | 20.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi tarifën dhe afatin e pajisjes me pasaportë biometrike | 21.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pasaporta me procedurë normale kushton 7500 (shtatëmijë e pesqind) lekë dhe afati ligjor është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti që keni aplikuar tek Identitek. Pasaporta me procedurë të përshpejtuar kushton 18000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë dhe afati ligjor është 3 (tre) ditë pune. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 49 | 21.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi mënyrën e pajisjes me certifikatë vdekje për nënën e ndjerë pasi nuk i gjenerohet në e-albania | 21.06.2024 | Përshëndetje z…..Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar".Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të Z…., i cili kërkon të informohet mbi mënyrën e pajisjes me certifikatë vdekje për nënën e tij të ndjerë pasi nuk i gjenerohet në e-albania. S'a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 50 | 20.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e aplikimit për informacion zyrtar mbi pasurinë | 21.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për çështjen që referoni në kërkesën për informacion, aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin: "Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)", të cilin e gjeni në linkun e mëposhtëm: **https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477** Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti. (sqaroni cfarë informacioni kërkoni mbi pronën). Kërkesa duhet të firmoset nga ana Juaj dhe të skanohet në formatin PDF e cila do të ngarkohet në hapin e tretë të aplikimit të shërbimit në e-Albania. Për të përdorur shërbimin, klikoni "Përdor" në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elekronik. Pavarësisht se Ju nuk keni të dhëna prone, për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të saktë kadastrale, ndërsa volumin dhe faqen i vendosni 99. Zona kadastrale duhet të jetë zona që përfshin zonën ku ndodhet objekti Juaj. Nëse keni të dhëna prone vendosini ato korrekt siç i keni në dokumentin e pronësisë. Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose në poste për të kryer pagesën, si dhe depozitimin me poste të kërkesës që keni bashkëlidhur aplikimit dhe mandatin e pagesës që do të kryeni. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoni. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 51 | 20.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi tarifën dhe afatin e pajisjes | 21.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pasaporta me procedurë normale kushton 7500 (shtatëmijë e pesqind) lekë dhe afati ligjor është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti që keni aplikuar tek Identitek. Pasaporta me procedurë të përshpejtuar kushton 18000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë dhe afati ligjor | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | me pasaportë biometrike | | është 3 (tre) ditë pune. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 52 | 19.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e mbylljes së pensionit të pleqërisë | 21.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, lutem gjeni mëposhtë përgjigjen e ardhur nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore si institucioni përgjegjës për shërbimin e kërkuar nga Ju.<br>Aplikim për mbyllje pensioni<br>• Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania<br>• Zgjidhni shërbimin "Aplikim për mbyllje pensioni"<br>• Klikoni butonin "Përdor"<br>• Plotësoni formularin përkatëse për këtë kërkesë<br>NID (Numri personal në Kartën tuaj të identitetit) plotësohet paraprakisht në momentin që ju hyni në portal me kredencialet tuaja. Me informacionin e NID (Numri personal në Kartën tuaj të identitetit) plotësohen automatikisht edhe të dhënat e tjera nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.<br>• Ju duhet të plotësoni formularin sipas fushave.<br>• Numri dhe data e protokollit do plotësohet nga punonjësit tanë.<br>• Dokumentet origjinale që i keni bashkëlidhur gjatë aplikimit duhet të dërgohen me postë pranë DRSSH përkatëse.<br>Nëpërmjet sherbimit postar duhet të paraqesni dokumentat si me poshtë:<br>Dy Certifikata vdekje: Nje Çertifikatë ku te cilesohet për sig shoqërore dhe një Çertifikatë ku të cilësohet për shpenzime funerali<br>Fatura Tatimore<br>Leja e varrimit<br>Fotokopje e kartës së identitetit të personit që tërheq shpenzimet.<br>Ju lutem mbani në konsideratë që zarfi i përcjelljes së këtyre dokumenteve të shoqërohet me numrin e aplikimit tuaj. Dite te mbare! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 53 | 21.06.2024 | Kërkesë e paplotë | 21.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, lutemi na kontaktoni në kanalet tona të komunikimit online brenda orarit zyrtar të komunkimit (08.00 - 19.00), pasi kërkesa juaj është e paqartë. Nëpërmjet dialogut specialistët tanë do T`ju asistojnë e orientojnë drejt shërbimit që duhet të aplikoni. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 54 | 21.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi tarifën dhe afatin e pajisjes me pasaportë biometrike | 24.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, bëjmë me dije se pasaporta me procedurë normale kushton 7500 (shtatëmijë e pesqind) lekë dhe afati ligjor është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti që keni aplikuar tek Identitek. Pasaporta me procedurë të përshpejtuar kushton 18000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë dhe afati ligjor është 3 (tre) ditë pune. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 55 | 23.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi numrin e references së aplikimit | 24.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se çdo aplikim pas dërgimit të tij me sukses, pajiset me një numër reference. Numri i referencës së aplikimit shfaqet dhe ruhet në opsionin “Mesazhet e mia” në llogarinë Tuaj në e-albania. Për shërbimet që janë me pagesë, si numër reference mund të shërbejë edhe numri i kërkesës tek mandat pagesa e shërbimit e cila ruhet në opsionin “Dokumentet e mia” në llogarinë Tuaj në e-albania. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 56 | 23.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e pajisjes me certifikatë martese | 24.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se për të përfituar certifikaë martesore ju duhet të aplikoni në shërbimin, "**Certifikatë nga akti i martesës (shqip / në gjuhë të huaj)".** **https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11178.** | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Shërbimi elektronik "Certifikatë nga akti i martesës (shqip / në gjuhë të huaj)" ju mundëson të shikoni dhe verifikoni të dhënat e certifikatës së aktit të martesës dhe të gjeneroni certifikatën e aktit sipas tipologjisë:<br>• **Certifikatë nga akti i martesës** sipas të dhënave aktuale, nëpërmjet së cilës mundësohet verifikimi i të dhënave sipas aktit të martesës.<br>• **Certifikatë nga akti i martesës** sipas regjistrimeve të mëparshme, në rastet kur shtetasit kanë lidhur më shumë se 1 (një) herë martese. Certifikata e aktit të martesës gjenerohet me vulë elektronike në shqip ose në gjuhë të huaj me vlerë të plotë ligjore.<br>**Hapat e procedurës**<br>• Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania;<br>• Zgjidhni shërbimin "Certifikatë nga akti i martesës (shqip / në gjuhë të huaj)";<br>• Klikoni butonin "Përdor";<br>• Përzgjidhni tipin e certifikatës duke zgjedhur periudhën përkatëse "Para vitit 2010" apo "Pas vitit 2010"; Për periudhën "Para vitit 2010" duhet të plotësohet seksioni me të dhënat e kërkuara dhe në fund klikoni butonin "Dërgo";<br>• Pasi aplikimi të dërgohet me sukses, do të merret në shqyrtim nga zyra e Gjendjes Civile përkatëse dhe certifikata do të dërgohet brenda 3 (tre) ditëve pune në llogarinë tuaj në portalin qeveritar e-Albania, në rubrikën "Dokumentet e mia";<br>• Për periudhën "Pas vitit 2010" duhet të plotësohet data për të cilën kërkohet certifikata e aktit dhe të klikoni butonin "Shfaq certifikatën". Certifikata nga akti i martesës sipas regjistrimeve të mëparshme do të gjenerohet menjëherë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGjC) i vitit 2010. Për shkarkimin e certifikatës nga akti i martesës sipas regjistrimeve të mëparshme klikoni butonin "**Shkarko dokumentin e vulosur**". | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • *Nëse ju nevojitet certifikata në gjuhë të huaj, klikoni butonin "Shfaq certifikatën në gjuhë të huaj"*;<br>Kujdes! Në rastin tuaj, lutemi provoni ta gjeneroni certifikaten e martesës jo me mbiemrin e vajzërisë, por me mbiemrin e e martesës. Në rast se përsëri nuk mund ta gjeneroni lutemi na shkruani në live chat www.adisa.gov.al që të kontaktojmë me lehtësi dhe të kuptojmë problemin tuaj. Faleminderit! | | |
| 57 | 23.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e pajisjes me pasaportë biometrike | 24.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se për të kryer aplikimin për pajisje me Pasaportë Biometrike për herë të parë, nevojitet të plotësoni online në portalin e-Albania formularin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke klikuar linkun :<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851<br>Klikoni opsionin "Përdor" dhe plotësoni formularin "Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës".<br>Gjatë aplikimit nevojitet ngarkimi i fotografisë në standardin 4x5cm në formatin jpg, jpeg ose png. Në rast se aplikimi është me procedurë të përshpejtuar (ose aplikim emergjent), nevojitet ngarkimi i fotos dhe i kopjes së kuponit të procedurës së përshpejtuar. Pas shqyrtimit të aplikimit do të njoftoheni në llogarinë Tuaj në e-albania në seksionin Dokumentet e mia, për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia. **Kushti për të aplikuar në linkun e mësipërm është që më parë të jeni e regjistruar në e-albania.**<br>Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 58 | 23.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e lidhjes së martesës me shtetas të huaj | 24.06.2024 | Përshëndetje, Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar): | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;<br>• Dokumentin / Certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);<br>• Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;<br>• Fotokopje e dokumentit të identifikimit.<br>Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:<br>• Certifikatë lindje;<br>• Certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”.<br>Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 59 | 23.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e regjistrimin e AMTP-së | 24.06.2024 | Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të aplikoni për të regjistruar aktin e marrjen në përdorim të tokës (AMTP). Ju mund të aplikoni për këtë shërbim online përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444 Kërkoni shërbimin "Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ" dhe aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit.<br>**KUJDES:** *pasi të keni plotësuar të dhënat personale dhe ato të pasurisë, në hapin e radhës do T'ju shfaqet shërbimi i kërkuar "Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ " i cili lidhet me kodin e shërbimit* **ASHK_R2**. *Në këtë faqe ju jepet mundësia të shtoni kode të tjera shërbimi të cilat* **duhen** *vendosur në mënyrë që aplikimi të quhet i plotë.*<br>**Shërbimet që duhen shtuar janë;**<br>- L1 (Lëshim çertifikate pronësie)<br>- I4 (Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale)<br>- I5 (Lëshim kopje kartele të pasurisë)<br>Pasi të kryeni aplikimin, Ju nuk duhet të prisni shërbimin postar për kthim-përgjigjen, por do të mund të merrni atë me vulë dhe firmë elektronike duke klikuar **"Dokumentat e Mia"** në profilin Tuaj në e-Albania. Aplikimi për regjistrimin e lejes së legalizimit dhe pajisjes me certifikatë pronësie nuk penalizohet me gjobë, por kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit të mësipërm. Në fund klikoni opsionin "Dërgo". Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose kredit. Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 60 | 23.06.2024 | Kërkesë e paplotë | 24.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të emailit tuaj, Ju lutem n'a dërgoni një kërkesë më të plotë që të kemi mundësinë tju informojmë. Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 61 | 21.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi tarifën dhe afatin e pajisjes me pasaportë biometrike | 24.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, bëjmë me dije se pasaporta me procedurë normale kushton 7500 (shtatëmijë e pesqind) lekë dhe afati ligjor është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti që keni aplikuar tek Identitek. Pasaporta me procedurë të përshpejtuar kushton 18000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë dhe afati ligjor është 3 (tre) ditë pune. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 62 | 21.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurë që duhet të ndjek për të pasqyruar ndryshimet e të dhënave personale në RGJC | 24.06.2024 | Përshëndetje z.Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të Znj…, e cila kërkon të informohet mbi procedurë që duhet të ndjek për të pasqyruar ndryshimet e të dhënave personale në Regjistrin e Gjendjes Civile. S'a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 63 | 24.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi vonesën e shërbimit fshirje hipoteke | 24.06.2024 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Bashkëngjitur | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | gjeni kërkesën e mëposhtme të Z….., i cili kërkon në mënyrë të përsëritur informacion mbi afatin e përfundimit të aplikimit me nr. 31624 datë 04.06.2024 lirim prone nga banka. Gjithashtu bashkëlidhur dhe email-i drejtuar në adresën tonë zyrtare. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të z….Faleminderit | | |
| 64 | 24.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e rinovimit të pasaportës biometrike | 24.06.2024 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse pasaporta ka skaduar pas vitit 2022, blini kuponin në postë dhe paraqituni në pikën Identitek prane gjendjes tuaj civile. Nuk ka nevoje për rezervim. Nuk ka nevojë pë aplikimin e formularit të policisë në e-albania. Për çdo pyetje e paqartësi na telefononi në numrin pa pagesë 0800 0118 nga e hëna në të premte nga ora 080.00 deri në orën 19.00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 65 | 24.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e aplikimit pension pleqërie | 25.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të dërguar kërkesën për pension pleqërie, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin: "Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundrues i nëndetëseve apo suplementar për akademik", në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6156 Logohuni me të dhënat Tuaja në e-albania, klikoni linkun e shërbimit, dhe në brendësi të aplikimit do gjeni edhe dokumentacionin e nevojshëm që do të ngarkoni në aplikim. Kujtojmë se dokumentacioni duhet të jetë në format PDF. Theksojmë se dokumenti më i rëndësishëm është libreza e punës, në bazë të së cilës do plotësoni dhe formularin lidhur me vitet dhe qendrat e punës para vitit 1994 dhe pas vitit 1994. Pasi të dërgoni aplikimin, dërgoni dokumentet të cilat i ngarkuat në aplikim me rrugë postare pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke vendosur mbi zarf numrin e referencës së aplikimit në e-albania. Nëse kërkoni informacion paraprak për vitet e punës aplikoni në e-albania shërbimet: | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Vërtetim për periudha pune në ndërmarrje shtetërore (para datës 01.01.1994) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13886 Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 01.01.1994 deri 31.12.2011 https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13888 Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13908 **Nëse keni librezën e punës të plotësuar për gjithë vitet e punës nuk keni detyrim ligjor të aplikoni vërtetimet, por as pengesë ligjore për t`i aplikuar.DRSSH- do të thotë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve shoqërore**. **ALSSH- do të thotë Agjencia Lokale e Sigurimeve Shoqërore. Janë të dhëna të qarkut dhe qytetit ku jetoni.**Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | | |
| 66 | 25.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e regjistrimit në e-albania | 25.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se regjistrimi në portalin qeveritar e-Albania mund të kryhet si për shtetasit shqiptarë, ashtu dhe për shtetasit e huaj të pajisur me leje qëndrimi në Shqipëri. Shtetasit shqiptarë regjistrohen nëpërmjet Numrit Personal të Identifikimit, të cilin e gjejnë në kartën e tyre të identitetit. Pasi të jetë hapur portali www.e-albania.al duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:<br>• Klikoni "Regjistrohu/Register"<br>• Plotësoni të gjitha të dhënat e specifikuara në formularin e regjistrimit<br>• Kodi i përdoruesit (NID: Numri personal i identifikimit) / User Personal Identification Number (NID): Është numri personal i identifikimit. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | <ul><li>Data e skadimit të kartës së identitetit / Identification document expiry date: Vendosni datën e skadimit të kartës së identitetit në formatin datë.muaj.vit.</li><li>Fjalëkalimi / Password: Sigurohuni që fjalëkalimi të jetë 8 deri në 12 karaktere i gjatë dhe nuk duhet të fillojë ose mbarojë me hapësira.</li><li>E-mail: Në këtë adresë do të vijë linku i aktivizimit të llogarisë dhe të gjitha njoftimet që kanë te bëjnë me aplikimet tuaja.</li><li>Numri i celularit / Mobile phone number: Sigurohuni që të vendoset në formatin e duhur. Për numrat shqiptarë formati është '06xxxxxxxx' ndersa për numrat jashtë Shqipërisë, formati i saktë është '0044/0039/0032xxxxxxxx', në varësi të shtetit ku jetoni.</li><li>Të dhënat personale (Emri / Name, Mbiemri / Surname, Atësia / Father Name, Mëmësia / Mother Name, Datëlindja / Birthdate): Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen më të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile.</li></ul>*Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë", ose "ç"*. Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civle do të keni vështirësi me regjistrimin kontaktoni ne adresen: **helpdesk@e-albania.al.** Plotësoni kodin katër shifror të dërguar me SMS në numrin tuaj të telefonit dhe klikoni në linkun e aktivizimit në adresën tuaj e-mail për aktivizimin e llogarisë tuaj. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 67 | 24.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi pagesën e shpenzimeve të transportit nga institucioni | 25.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është jashtë kompetencës së institucionit tonë. Për më shumë informacion referohuni linkut të mëposhtëm: https://ndihmajuridike.gov.al/. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 68 | 24.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi rinovimin e patentës së humbur | 25.06.2024 | Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se në rastin e humbjes së dokumentave të ndryshme, ju duhet të denonconi humbjen e dokumentit, në rastin tuaj Lejen e Qarkullimit, në linkun e mëposhtëm:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14922<br>**Hapat e procedurës**<br>• Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania;<br>• Zgjidhni shërbimin "Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme";<br>• Klikoni butonin" Përdor";<br>• Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular;<br>• Pas përgatitjes së vërtetimit të humbjes, ju do të njoftoheni me e-mail dhe te seksioni “Dokumentet e mia” në e-Albania.<br>**Sapo t'ju vij konfirmimi në sistem do vijoni me procedurën e aplikimit për rinovimin e patentës pranë sporteleve të DPSHTRR-së.** Dokumentet që duhen me vete kur të paraqiteni në sportelin e DPSHTRR-së janë:<br>• Dokument identifikimi;<br>• Certifikatë mjekësore me fotografi, e cila vërteton aftësinë shëndetësore për të drejtuar mjetin rrugor;<br>• Lejen e drejtimit aktual që zotëron.<br>Tarifa:<br>• Rinovimi i lejes së drejtimit: 3,500 lekë.<br>• Për të gjitha rinovimet e lejeve të drejtimit të kategorisë B që janë me afat 3/5-vjeçar ose janë me kufizime për shkaqe shëndetësore: 2,000 lekë.<br>Ku dhe kur tërhiqet Leja e re e Drejtimit?<br>• Leja e re e Drejtimit tërhiqet pranë sporteleve të shërbimit të Drejtorive Rajonale ku është bërë aplikimi. Në Tiranë, leja e drejtimit tërhiqet për 30 minuta në zyrat e shërbimit te ish-NSHRAK. Në Drejtoritë e tjera Rajonale, kjo procedurë | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mund të zgjasë 3-5 ditë pune. Ju mund të gjurmoni lejen tuaj të re të drejtimit për të parë nëse është dërguar te drejtoria rajonale:https://www.dpshtrr.al/gjurmim-lejedrejtimi!<br>**Kujdes! Në rast se nuk jeni i rregjistruar si shtetas shqiptar, ju nuk mund të kryeni deklarimin e humbjes së patentës. Për të vijuar me logimin në e-albania duhet të keni mjet identifikimi shqiptar, Kartë Identiteti apo passaportë.** Në mënyrë që t`ju jemi sa më shumë në ndihmë, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | | |
| 69 | 25.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për lidhje martese me shtetas të huaj | 26.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është **shpallja e martesës.** Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentacioni i nevojshëm për shtetasin shqiptar në Republikën e Shqipërisë është:<br>• Letërnjoftim elektronik dhe jo pasaportë;<br>• Prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes;<br>Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:<br>• **certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;**<br>• **dokumentin/certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);**<br>• **dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;** | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • **fotokopje e dokumentit të identifikimit;**<br>• **prokurë e posaçme, në rastin kur nuk është prezent në procedurën e shpalljes.**<br>Këto dokumente duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). **Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, keni të drejtë ligjore të lidhni martesën duke pasur me vete dhe dy dëshmitarë me karta identiteti brenda afatit të vlefshmërisë.** Pas lidhjes së martesës, Certifikata nga akti i martesës, legalizohet në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të regjistrohet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | | |
| 70 | 26.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për lidhje martese me shtetas të huaj | 26.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është shpallja e martesës. Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentacioni i nevojshëm për shtetasin shqiptar në Republikën e Shqipërisë është:<br>• Letërnjoftim elektronik dhe jo pasaportë;<br>• Prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:<br>• certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;<br>• dokumentin/certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);<br>• dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;<br>• fotokopje e dokumentit të identifikimit;<br>• prokurë e posaçme, në rastin kur nuk është prezent në procedurën e shpalljes.<br>Këto dokumente duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, keni të drejtë ligjore të lidhni martesën duke pasur me vete dhe dy dëshmitarë me karta identiteti brenda afatit të vlefshmërisë. Pas lidhjes së martesës, Certifikata nga akti i martesës, legalizohet në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të regjistrohet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | | |
| 71 | 26.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për pasqyrimin e ndryshimit të | 27.06.2024 | Përshëndetje z….Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të dhënave personale në RGJC | | kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të Z…. i cili kërkon të informohet mbi procedurë që duhet të ndjek për të pasqyruar ndryshimet e të dhënave personale në Regjistrin e Gjendjes Civile. S'a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit! | | |
| 72 | 27.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi plotësimin e AV | 27.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se tek rubrika e parë ku kërkon nr e referncës nuk duhet të vendosni këtë numër por nr 5 shifror që ndodhet tek fleta e aplikimit me të cilin ke kryer pagesën. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 73 | 28.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e regjistrimit të lejes së legalizimit | 28.06.2024 | Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se fillimisht nuk citohet në asnjë nga shkresat që dokumentet duhet të dorëzohen nëpërmjet ADISA. Nëpërmjet shërbimeve online duhet të aplikoni për të regjistruar aktin e legalizimit. Ju mund të aplikoni për këtë shërbim online përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444 Kërkoni shërbimin "Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ" dhe aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit. **KUJDES:** *pasi të keni plotësuar të dhënat personale dhe ato të pasurisë, në hapin e radhës do T'ju shfaqet shërbimi i kërkuar "Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ " i cili lidhet me kodin e shërbimit* **ASHK_R2**. *Në këtë faqe ju jepet mundësia të shtoni kode të tjera shërbimi të cilat* **duhen** *vendosur në mënyrë që aplikimi të quhet i plotë.*<br>**Shërbimet që duhen shtuar janë;**<br>- L1 (Lëshim çertifikate pronësie)<br>- I4 (Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale)<br>- I5 (Lëshim kopje kartele të pasurisë) | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Pasi të kryeni aplikimin, Ju nuk duhet të prisni shërbimin postar për kthim-përgjigjen, por do të mund të merrni atë me vulë dhe firmë elektronike duke klikuar **"Dokumentat e Mia"** në profilin Tuaj në e-Albania. Aplikimi për regjistrimin e lejes së legalizimit dhe pajisjes me certifikatë pronësie nuk penalizohet me gjobë, por kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit të mësipërm. Në fund klikoni opsionin "Dërgo". Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose kredit. Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 74 | 28.06.2024 | Kërkesë për informacion mbi procedurën për reset password | 28.06.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalëkalimin, për të gjeneruar një password të ri duhet të veproni si më poshtë:Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al :<br>Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme:<br>• foto të kartës ID<br>• emri i nënës<br>• emri i babait<br>• vendlindja e nënës<br>Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5 (pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 75 | 28.06.2024 | Kërkesë për asistencë mbi problematikën e fshaqur në portalin e-albania | 28.06.2024 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni mëposhtë kërkesën e qytetarit për asistencë për një problem në përfundimin e dërgimit të AV0 nëpërmjet portalin e-albania.Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të qytetarit. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |